



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN KOORDINIMIT DHE INFORMIMIT PUBLIK  
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 121/14 Prot.

Patos, më 25/01/2022

**PROCES-VERBAL**

I mbajtur sot në datë 24.01.2022 ora 11:00 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, ku organizohet seanca dëgjimore e Këshillit të Bashkisë lidhur mbi “Diskutimin e Rregullores së Konsultimit për Këshillin Bashkiak”

Pjesëmarrës në këtë mbledhje janë:

1. Anëtarë të Këshillit Bashkiak
2. Kryetare e Komisionit të Ekonomi financës znj. Elda Golloshi
3. Sekretari i Këshillit
4. Kryetar të fshatrave të ndodhur në teritorin e Bashkisë Patos
5. Banorë të qytetit dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile

Takimi hapet nga Kryetarja e Komisionit të Ekonomi Financës znj Elda Golloshi

Elda Golloshi – Mirdita. Përpara se të fillojmë me takimin më lejoni që në radhë të parë t’ju falenderoj për pjesëmarrjen në këtë takim i cili është i pari për këtë vit. Sot jemi në këtë takim për të diskutuar Rregulloren e Konsultimeve Publike të Këshillit të Bashkisë. Ky është një dokumet i hartuar nga në kuadër të projektit Bashkit të Forta, i zbatuar nga Helvetas dhe i financuar nga Qeveria Zvicerane, për të cilën Sekretari i Këshillit do të na japi më shume detajet mbi të. Balil fjala është për ju.

Balil Balili – paraqet materialin lidhur mbi Rregulloren e Konsultimeve të Këshillit të Bashkisë Patos.

Balil Balili – Ashtu sic e tha edhe Elda, se kjo rregullore është në kuadër të projektit Bashkit të Forta, i hartuar nga shoqata Helvetas dhe i financuar nga Qeveria Zvicerane e cila ka nje marreveshje me Bashkine Patos dhe kjo rregullore përcakton qartë rregullat dhe procedurat e

këshillimit me publikun duke siguruar transparencën e politikëbërjes dhe vendimmarrjes të akteve që miraton Këshilli i Bashkisë. Me pak fjalë, kjo rregullore na detyron të tërheqim mendimin tuaj me qëllim që cdo vendimmarrje e Këshillit Bashkiak të jetë në përputhje me ligjet dhe në interes të qytetarëve. Gjithashtu du atë theksoj se kjo rregullore është e publikuar edhe në faqen e Këshillit dhe deri në ditën kur do të zhvillohet mbledhja ne presim komentet apo sygjetimet tuaja. Fjala është për ju.

Antonela Kola – ju këtë material e keni publikuar edhe në faqen zyrate të bashkisë dhe në gjykimi tim Rregullorja e konsultimit se është një dokumet i plotë dhe i hartuar i mirë nga ana e hartuesve të tij duke plotësuar kuadrin ligjor mbi konsultimet, nuk kam vrejttje për materialin.

Elmira Rama ( këshilltare) – ajo që unë doja të vija theksin është se kjo rregullore na detyron ne si Këshill që për vendimet që ne duhet të marrim duhet me patjetërtë që ne të garantojmë jo vetëm pjesëmarrjen aktive të publikut në procesin e hartimit dhe rishikimit të politikave, akteve, rregulloreve etj por edhe tju sigurojmë atyre se janë një hallkë e rëndësishme në vendimmarrjet tona duke qenë një busull e mirë orientimi dhe këshillimi për Këshillin Bashkiak.

Timo Isufaj ( Kryetar i fshatit Banaj) nuk kemi anjë kundështim për materialim.

Balil Balili – me Kryetaët e fshatrave ne vazhdimisht realizojmë takime me komunitetin edhe pa u hartuar kjo rregullore pasi është një detyrim ligjor që ne të marrim mendimet dhe sygjerimet tuaja përpara cdo vendimi.

Elda Goxhaj – sic edhe u tha ne jemi në pritje të mendimeve tuaja. Nëse nuk eni gjë tjetër për të shtuar unë ju falenderoj edhe një herë për pjesëmarrjen tuaj dhe padyshim që do të shihemi në takime të tjera.

**Koordinator**  
**Për Konsultimin Publik**  
**Suzana Hysenaj**

